

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Orkestra Simfonike çel sezonin e ri
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/orkestra-simfonike-cel-sezonin-e-ri-i586704
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:34:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:33:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	99e8427bb1c545e399803e3d7729c2e29fa7bb6460a8b4b65a4fec33f40eb00b
TEKSTI	5387df93358d4e226c651ce8c6c2bfcc20b8134f4fb9c80b25b8e33eac9a95b5
PAMJA	a1f72d76eebbb64f1aeeaac69c48c92a332fba984b987576e8f59dc715472125

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6ffb5ad5bda100c040db07289a2486421c8ccc372d1b209c58073d56eb39a58b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6ffb5ad5bda100c040db07289a2486421c8ccc372d1b209c58073d56eb39a58b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

1 e [Orkestra Simfonike çel sezonin e ri&I vite burg per ish-kreret e UÇK-se, mazhoranca dhe opozita ne nje ze: Vendim i padrejte, nje aktgjykim nuk mund te rishkruaje histe fundit](#)

Orkestra Simfonike çel sezonin e ri

TemA

17 Shtator 2026, 15:33Kulturë TEMA



Shtatori erdhi me tingujt e parë të një stine të re koncertore. Në skenë, aty ku muzika klasike gjen gjithmonë një mënyrë për të komunikuar me publikun, Orkestra Simfonike e Radio Televizionit Shqiptar çeli sezonin e ri koncertor me një mbrëmje të veçantë.

Nën drejtimin e maestro Gridi Kraja, instrumentistët e Orkestrës Simfonike të RTSH-së përcollën në skenë një repertor që ndërthurte elegancën e muzikës klasike me ngjyrimet dhe identitetin e krijimtarisë shqiptare. Çdo tingull, çdo ritëm dhe çdo interpretim krijoi një atmosferë të veçantë, duke e kthyer këtë koncert në një pikënisje premtuese për sezonin e ri.

“Është një emocion i veçantë kur luhet një krijim i yti. Pavarësisht se unë mendoj që është një krijim modest, kur e luan vetë, e interpreton vetë dhe me orkestrën tënde, emocionet janë të përziera. Megjithatë, eksperiencia ishte shumë e bukur. Unë e shijova shumë”, u shpreh dirigjenti, Gridi Kraja.

Në qendër të mbrëmjes ishte edhe virtuoiziteti i pianistit Matia Cerriku, interpretimi i të cilit i dha programit një tjetër dimension. Përmes dialogut mes solistit dhe orkestrës, publiku përjetoi një mbrëmje ku forca e muzikës simfonike u ndërthur me ndjeshmërinë dhe teknikën e interpretimit.

“Një ndjesi madhështie të luajmë me Orkestrën e Radio Televizionit. Është një nismë shumë e bukur dhe më jep motivimin për të vazhduar akoma më përpara”, tha pianisti Matia Cerriku.

Koncerti nuk ishte thjesht një hapje e sezonit. Ishte një rikthim te skena, te tingulli i gjallë dhe te komunikimi i drejtpërdrejtë mes muzikantëve dhe publikut. Një mbrëmje që solli në vëmendje edhe një herë rolin e Orkestrës Simfonike të RTSH-së në pasurimin e jetës kulturore dhe muzikore shqiptare. Një sezon ku muzika klasike synon të vijojë të jetë pranë publikut, të krijojë emocione të reja dhe të sjellë në skenë histori të rrëfyera përmes tingujve. A.K./TemA



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Andrej Kurkov vjen në COD](#)

15:09 Kulturë

Rritet numri i vizitorëve në Kalanë e Lezhës

13:20 Kulturë

41 vepra të piktorit të njohur shqiptar Ibrahim Kodra do të prezantohen së bashku në ekspozitën "Deti dhe Muzika"

11:29 Kulturë

VIDEO: Nga mitet te dokumentet: koha për ta rilexuar të shkuarën

09:51 Kulturë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.